

## KUMTESA

MAHIR DOMI

### PARIMI FONETIK E ZBATIMI I TIJ NË DREJTSHKRIMIN E SHQIPES

Po t'i hedhim një sy, sado të shpejtë, drejtshkrimit të gjuhëve të ndryshme, vemë re ndryshime, herë-herë të mëdha, ndërmjet tyre, kryesisht lidhur me raportin midis shkrimit dhe gjuhës së folur, duke qenë të kushtëzuara ato nga zhvillimi historik i gjuhëve përkatëse, nga ecuria e zhvillimit të gjuhëve letrare dhe nga pikëpamjet që kanë zotëruar në lëvrimin e këtyre. Dallohen kryesisht drejtshkrimet *fonetike* dhe drejtshkrimet *historike* ose *historike-etimologjizuese*. Të parat karakterizohen nga përputhja pak a shumë e madhe me gjuhën e folur, me gjuhën e gjallë, ndërsa të dytat nga shkëputja e theksuar prej saj, nga ruajtja në të shkruar e fazave të kaluara të gjuhëve përkatëse.

Shkrimi i një gjuhe në fillimet është i lidhur ngushtë me të folurit. Gjuha e folur ndryshon gradualish, e në mënyrë të vijueshme, ndërsa shkrimi, duke qenë i ngulitur, mbetet i pandryshuar. Largimi, i përfutur kështu ndërmjet tyre, me kalimin e kohës mund të bëhet shumë i ndieshëm. Kur një gjuhë, gjatë zhvillimit historik, ka pësuar ndryshime të mëdha, sidomos fonetike, po drejtshkrimit të saj s'i janë bërë nga koha në kohë rivështime e modifikime për ta afruar, aq sa është e mundur, me sistemin fonetik të gjallë, krijohet një hon i vërtetë midis aspekteve të shkruar e të folur të gjuhës letrare, i cili vësh-tirëson shumë përvetësimin e rregullave drejtshkimore, ndikon në mënyrë negative në përgjithësimin e plotë të normave letrare, bëhet pengesë për përhapjen sa më të gjerë të fjalës së shkruar, të kulturës në masat popullore. Të tilla gjendje të pakënaqshme janë krijuar p.sh. në drejtshkrimet e gjuhëve si frengjishtja, anglishtja etj. Kështu drejtshkrimi i frengjishtes mund të thuhet se pasqyron në tiparet e tij kryesore gjuhën e folur të shekujve XII-XIII, pa marrë parasysh, veçse në masë të vogël, ndryshimet e mëdha fonetike që ka pësuar kjo gjuhë gjatë këtyre gjashtë shekujve të fundit.

Gjuha shqipe ka një drejtshkrim fonetik, mund të themi ndër më fonetikët që ekzistojnë. Kjo u detyrohet një sërë faktorëve, gjuhësorë e historikë:

1) Gjuha shqipe në aspektin e përgjithshëm, gjatë shekujve të shkrimit të saj, nuk ka pësuar transformime të thella fonetike, ndryshime janë vërtetuar kryesisht në planin dialektor.

2) Në ngjizjen e gjuhës së sotme letrare gjatë Rilindjes u muar

për bazë gjuha e gjallë, gjuha popullore dhe jo tradita shkrimore e mëparshme. Kjo e fundit s'ishte as aq e fuqishme as e përshtatshme për të dhënë mjetin që i nevojitej kulturës së re shqiptare e lëvizjes kombëtare. Në këtë mënyrë u krijuan premiset e nevojshme për një drejtshkrim fonetik dhe u mënjanuan ose u pakësuan mundësitë e një drejtshkrimi historik-arkaik ose historik-etimologjik.

3) Rilindasit e pajisën shqipen me një alfabet fonetik të thjeshtë, shkencor e praktik, të mbështetur në një lidhje të drejtpërdrejtë e të rregullt midis tingujve dhe grafemave. Alfabeti i Stambollit, i hartuar në fazën përfundimtare të tij nga mendja e kthjelltë dhe gjeniale e Sami Frashërit, i qëndroi gjer në fund besnik parimit shkencor «një tingull me një shkronjë dhe një shkronjë për një tingull». Megjithë diagramet e futura në alfabetin e përpiluar nga Kongresi i Manastirit (1908), që u bë alfabeti i përgjithshëm i shqipes, mbeti në gjuhën shqipe parimi themelor i shenjimit të një tingulli gjithnjë me të njëjtën shenjë, qoftë kjo monogramë a diagramë, si dhe i përdorimit të së njëjtës shenjë grafike përherë me të njëjtën vlerë tingëllore. Kjo jepte dorë mjaft për përpunimin e një drejtshkrimi në një shkallë të madhe fonetik e të thjeshtë. Shkrimi i gjuhës shqipe nuk vuan nga ndërlikimet e vështirësitë e drejtshkrimeve ku i njëjti tingull jipet shumë shpesh nëpërmjet shkronjash ose togje shkronjash të ndryshme, e anasjelltasi një shkronjë a një tog shkronjash del me vlerë fonetike të ndryshme. Me raportin e qëndrueshëm ndërmjet tingujve dhe shkronjave, shumica e fjalëve kanë ortografi vetvetiu fonetike, duke mos u bërë fare problem drejtshkrimor, si p.sh. fjalët *mal, gur, i keq, besnik, fusha, hap, shes, sot, kur, ku, si, sa, pak* etj.

Vendosja në themel të gjuhës letrare e gjuhës popullore të gjallë, me larminë e lëvizshmërinë e saj karakteristike, me luhatjet e variacionet e saj dialektore, që duhej ngritur në shkallën e një gjuhe të zhvilluar e të përpunuar kulture, përcaktoi punën që ishte për t'u bërë, problemet që ishin për t'u përballuar në rrugën për arritjen në një gjuhë letrare të normativizuar e njësuar. Ajo përcaktoi ndër të tjera edhe rrugën që do të merrte përpunimi i çështjeve drejtshkrimore, kriteret që duhej të ndiqeshin, karakterin kryesisht fonetik të drejtshkrimit, por edhe nevojën e kombinimit e plotësimit të tij me parimin morfologjik, në raste të veçanta edhe në ndonjë parim a kriter tjetër.

Parimi fonetik u bë parim udhëheqës i drejtshkrimit të shqipes. Ky drejtshkrim në zhvillimin e tij u foneticizua gjithnjë e më tepër, në një anë duke u shkarkuar nga ndonjë grafi historike-etimologjizuese e papërligjur, në anë tjetër duke ndjekur proceset e rëndësishme evolutive fonetike të ndodhura në gjuhën e gjallë e duke regjistruar rezultatet e kristalizuara të tyre, për të qenë sa është e mundur më afër të folurit.

Komisia letrare e Shkodrës e vitit 1916 shpallte në krye të vendimeve të saj për kodifikimin drejtshkrimor: «Orthografia e gjuhës do të jetë fonetike, d.m.th. gjuha do të shkruhet si flitet sot prej popullit». Parimi fonetik qëndroi parimi themelor i praktikës gjuhësore dhe i mendimit gjuhësor shqiptar. Ndonjë shkrim arkaik etimologjizues e ndonjë orvatje për t'u kthyer në një drejtshkrim historik etimologjik nuk gjetën asnjë jehonë. «Pra — shkruante Prof. A. Xhuvani më 1944 — është një gja e pamundur që të kthehemi në të vjetrat, tue pranue një mënyrë shkri-

mi të bazuem mbi etimologjinë... Sot bota përpiqen gjithnji që të afrojnë ortografinë me fonetikën tue mos marrë parasysh etimologjinë».

Në rrugën e një drejtshkrimi fonetik u zhvillua edhe puna e madhe e bërë pas Çlirimit për përcaktimin, njësimin gjithnjë e më të madh të rregullave drejtshkrimore të gjuhës sonë, punë që u kurorëzua me Projektin e drejtshkrimit, i cili u botua më 1967 e që ky Kongres po merr në shqyrtim definitiv.

Në parimet e përgjithshme të këtij drejtshkrimi është thënë: «Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: fjalët shkruhen ashtu si shqiptohen. Parimi fonetik i drejtshkrimit të shqipes plotësohet edhe nga parimi morfologjik, d.m.th. nga synimi që të ruhen sa më të qarta në shkrim struktura dhe njësia e trajtave, si edhe struktura e formimit të fjalëve».

Lidhur me interpretimin e zbatimin e këtyre parimeve, me vendin e kombinimin e tyre në drejtshkrimin e shqipes, për zgjidhjet konkrete, në ndonjë rast edhe në shtrimin parimor, janë shfaqur gjatë diskutimit edhe mendime të ndryshme, çka e bën të nevojshëm zberthimin e shohitjen e tyre.

Parimi fonetik ka qenë, mbetet e duhet të jetë edhe në të ardhshmen parimi udhëheqës, themelor i drejtshkrimit të gjuhës sonë. Por zbatimi i tij absolut, kudo e kurdo, tërësisht dhe pa asnjë kufizim, s'është i mundshëm as i volitshëm as i dëshirueshëm. Sistemi fonetik i një gjuhe është gjithnjë shumë më kompleks se sistemi i saj grafik. Gjuha letrare ka edhe veçoritë e saj që e dallojnë nga gjuha e përgjithshme, shkrimi veçoritë e tij që e dallojnë nga të folurit. Gjuha e shkruar, si dihet, i shtrohet më shumë se gjuha e folur rregullimit të vetëdijshëm në formën e rregullave të caktuara të detyrueshme për të gjithë ata që shkruajnë, në të vepron më shumë parimi i normës. Drejtshkrimi duhet jo vetëm të japë sistemin fonetik të një gjuhe në elementet e tij kryesore, në tiparet e tyre themelore, por edhe të ndihmojë në të kapurit sa më mirë të përmbajtjes të së dhënës gjuhësore. Për realizimin e kësaj detyre të fundit kontribuon parimi morfologjik që është i nevojshëm të plotësojë në kushte e në rrethana të caktuara parimin fonetik duke u kombinuar me të. Ja përse janë të papërligjura kërkesat për një drejtshkrim tërësisht e ekskluzivisht fonetik, për foneticizimin e skajshëm të tij, për përputhjen e plotë e gjer në fund të shkrimit e të shqiptimit. Përshtatja e shkrimit me shqiptimin ka edhe ajo kufijtë e saj. Drejtshkrim absolutisht fonetik s'ka pasur, s'ka, as mund të ketë.

1. Drejtshkrimi, qoftë më fonetiku, nuk mund të pasqyrojë me besnikëri e përpikmëri larminë e jashtëzakonshme të tingujve të një gjuhe, me nuancat e ngjyrimet që ata marrin në kontekstet e rrethanat e ndryshme në të cilat gjinden. Një gjë të tillë e bën, po jo edhe në formën ideale, vetëm transkriptimi fonetik, i përdorur në rregjistrimet dialektore e në raste të tjera, me shenjat e veçanta a plotësuese të shumta që zotëron. Numri detyrimisht i kufizuar i shkronjave të një alfabeti është i pamjaftueshëm për këtë. Me to shënohen elementet e tiparet fonetike kryesore të dallueshme e dalluese. Edhe me anë vëzhgimesh të vëmendshme të realizuara vetëm me vesh, ne mund të vemë re pa zor të madh se një tingull, zanore ose bashkëtingëllore qoftë, nuk realizohet kudo e kurdo tamam në të njëjtën mënyrë. Timbri i tij

ndryshon sipas tingujve që ka pranë, ritmit të të folurit, llojit të të folurit, individëve dhe faktorëve të tjerë. Po këto ndryshime jothemelore mbesin jashtë vetëdijes së folësve të një gjuhe. Vetë sistemi i kumtimit nuk ndien nevojën e këtyre dallimeve, atij i mjaftojnë një numër i kufizuar elementesh. Alfabeti, dhe si pasojë drejtshkrimi, ndër tingujt konkretë, mund të themi të panumërt, që ekzistojnë realisht në një gjuhë, pasqyron vetëm themeloret dhe jo variantet e tyre, pasqyron njësitë funksionale me fjalë të tjera fonemat.

Edhe po të kishte mundësi për të dhënë me besnikëri shqiptimin real me luhatjet e lëvizjet e tij, të përcaktuara nga faktorë të ndryshueshëm, drejtshkrimi s'do arrinte të formulonte rregulla të përgjithshme, të njëjta si për shkruarit ashtu edhe për folësit e një gjuhe, s'do të përmbushte rolin e tij kodifikues.

Dihet se në drejtshkrim gjen zbatim edhe parimi fonematik që përputhet me parimin fonetik në vështrimin e tij të përgjithshëm tradicional, por jo tërësisht me parimin fonetik në vështrimin e përpiktë të tij. Parimi fonematik dallohet prej parimit të mirëfilltë fonetik, se ruan identitetin, njësinë e fonemave, pavarësisht nga realizimi i tyre i ndryshëm në vartësi nga faktorët pozicionalë dhe kombinatorë. Parimi fonematik lot rol të ndieshëm në ato gjuhë ku lëvizja e theksit sjell ndryshime të shumta të timbrit të zanoreve dhe ndodhin shndërrime fonetike të shpeshta, si p.sh. rusishtja.

Të tilla fenomene nuk janë karakteristike për shqipen. Në gjuhën tonë parimin fonematik e kemi të zbatuar në shkrimin e bashkëtingëlloreve të zëshme *dh, d, b, g, gj* në fund të fjalës ose para bashkëtingëlloreve të pazëshme, duke përkuar këtu edhe me parimin morfologjik, po në shkrimin e parashtesës *sh/ç*, nuk ruhet ai, po zbatohet parimi fonetik. Si pasojë, megjithëse parimi themelor i drejtshkrimit tonë në përgjithësi synon të japë sistemin fonematik, ai nuk përkon gjithnjë me parimin fonematik, prandaj s'del i përligjur emërtimi «fonematik» i tij. Është më i volitshëm e i saktë emërtimi «fonetik» i kuptuar ai në vështrimin e tij të përgjithshëm tradicional e jo në kuptimin e ngushtë e të përpiktë.

Si pasojë nuk dalin të përligjura gjithnjë kërkesat për ndryshimin e këtij ose atij ortogrami me motivimin se nuk i përgjigjet saktësisht shqiptimit. Ndërmjet shqiptimit dhe shkrimit s'ka përkim ideal.

2. Nëse, në bazë të parimit fonetik, drejtshkrimi do të synojë t'i qëndrojë sa më afër gjuhës së gjallë, shqiptimit, për të mos lënë të krijohet një hendek i madh midis gjuhës letrare dhe gjuhës popullore, gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, del nevoja e përcaktimit të shqiptimit që duhet marrë për bazë, e rrugës që duhet ndjekur për të arritur në ortograme të njësuara, atëhere kur gjuha e folur paraqet variante të ndryshme shqiptimore të kushtëzuara nga faktorë të ndryshëm, fjala vjen nga variacionet dialektore e gjurmat e ndikimit të tyre, luhatjet e zakonshme të të folurit etj. Lidhur me parimin «fjalët shkruhen ashtu si fliten» në zbatimin e tij ka herë herë keqkuptime. Është vënë re se janë bërë mjaft herë propozime të ndikuara nga shqiptimi i ambientit, vendit, trevës ku jetohet, nga trajta që ndihet si më e përdorur aty, duke e identifikuar këtë shqiptim me shqiptimin më të përgjithshëm që është dhënë disa herë si motivim i zgjidhjeve në rregu-

llat e drejtshkrimit. Është e vetëkuptueshme se drejtshkrimi s'mund të mbështetet mbi këtë bazë, të ngushtë e të ndryshueshme, ai kërkon një bazë më të përgjithshme, më të qendrueshme, shkencore e objektive. Së pari, drejtshkrimi mbështetet në shqiptimin letrar. Është e vërtetë se drejtshqiptimi është pjesa normative e gjuhës letrare të aspektit të folur që kristalizohet më vonë, se ai mbetet prapa drejtshkrimit. Kjo është edhe më e dukshme në gjuhën tonë, që sapo ka hyrë në fazën e kristalizimit përfundimtar të saj. Pastaj edhe në gjuhët më të përpunuara, me tradita letrare të vjetra, drejtshqiptimi nuk arrin në një njësim e konsolidim të plotë, ideal. Po nëse ne nuk kemi ende një drejtshqiptim si sistem tërësor të përcaktuar në të njëjtën shkallë në të gjitha hallkat e elementet e tij, me të gjitha tiparet e veçanta të tij, s'mund të mohohet se ne kemi tanimë një shqiptim letrar të përvijuar mjaftësisht qartë, në pjesën më të madhe të formuar a në formim e sipër, që gjithnjë e më tepër njësohet e stabilizohet. Ai është realiteti gjuhësor që duhet të pasqyrojë drejtshkrimi.

Po janë të shumta edhe rastet kur shqiptimi letrar, me luhatjet e variacionet e tij, nuk jep mbështetjen e nevojshme për caktimin e ortogrameve përkatëse. Atëhere i duhet drejtuar bazës dialektore kryesore të gjuhës letrare, shqiptimit që i përshtatet më mirë sistemit fonetik të saj, në raste të caktuara dendurisë së përdorimit, përhapjes së një trajte a fakti, duke përfshirë këtu edhe shtrirjen gjeografike, duke i parë këto dy mbështetje në lidhjen dialektike midis tyre. Është fakt se shqiptimi realisht më i përhapur e ka më lehtë të përgjithësohet, të bëhet më shpejt normë e përgjithshme dhe duhet marrë në konsideratë, kur s'vjen në kundërshtim me tiparet themelore të sistemit fonetik të gjuhës letrare.

Përcaktimi i të dhënave objektive që janë të lidhura me këto dy baza është i mundshëm, në mbështetje të rezultateve të arritura nga studimet tona fonetike, gramatikore, dialektologjike, gjuhësore-letrare dhe me ndonjë gjurmim të mëtejshëm që mund të dalë i nevojshëm për ndonjë çështje.

3. Gjuha, me elementet përbërëse të saj është në lëvizje të vijueshme, në zhvillim të ngadalshëm, por të pandërprerë. Në çdo moment të saj gjen procese në shtjellim e sipër, në faza të ndryshme të këtij shtjellimi e si pasojë me përfundime të ndryshme. Drejtshkrimit i takon të sjellë rregullsi e kristalizim në këtë realitet të lëvizshëm. Po si? Drejtshkrimi s'ka si të ndjekë hap për hap gjithë këtë lëvizje, të regjistrojë në çast rezultatet e pjesshme e të ndryshme të saj, aq më pak tendencat që nuk kanë gjetur realizim të plotë e tërësor. Ai do të presë kryerjen plotësisht të proceseve, konsolidimin dhe përgjithësimin e përfundimeve. Kur s'janë arritur këto, është më e arësyeshme të mbahen ortogramet ekzistuese, tradicionale. Po kur shndërrimet fonetike janë kthyer në fakte të qarta të pamohueshme, të përgjithshme, e janë konsoliduar në gjuhë, ato duhet t'i pasqyrojë drejtshkrimi, duke u shkarkuar nga trajta që në ndijën gjuhësore të përgjithshme janë bërë tanimë krejtësisht arkaike. Me këtë sy, pa u nxituar, mendoj, duhen parë çështjet e ndërlikuara të shumta që i nxjerr drejtshkrimit të gjuhës sonë, ë-ja e patheksuar, që del sot si një tingull i paqëndrue-

shëm, i dobësuar në shkallë të ndryshme, e si pasojë i një dëgjueshmërie të ndryshueshme.

4. Shkrimi nuk mund të ndjekë shqiptimin e të folurit të përditshëm, të stilit bisedor, në tendencat e skajshme erozive të tij, në gjithë reduktimet, sinkopimet e alteracionet e shpeshha fonetike. Në raste të caktuara të nevojshme, ai mund të mbajë trajtat më të plota, t'u ikë trajtave jo aq «të harmonishme» duke gjetur mbështetje edhe në traditën letrare, duke mos u përputhur me shqiptimin e zakonshëm zotërues. Të këtilla mund të jenë disa raste të lidhura me ë-në paratheksore. Si e thamë shkrimi dhe shqiptimi kanë edhe veçoritë e tyre e mund të mos përkojnë kudo e kurdo gjer në hollësitë më të vogla. Nuk duhet harruar se në formëzimin e shqiptimit letrar s'mbetet pa marrë pjesë edhe drejtshkrimi. Këto dy aspekte të gjuhës letrare janë në lidhje dialektike midis tyre, drejtshkrimi mbështetet përgjithësisht në shqiptimin letrar, por ndikon edhe mbi të, mund t'i prijë në njësim e kristalizim më se njëherë atij. Këtë na e tregon historia e gjuhëve letrare. Kjo do të ndodhë aq më shumë në gjuhën tonë në fazën e tanishme të zhvillimit dinamik të saj e të kristalizimit përfundimtar. Zgjidhjet e drejtshkrimit, të vendosura mbi baza shkencore, do të përcaktojnë në më se një rast edhe rregullën përkatëse të drejtshqiptimit.

5. Drejtshkrimi duhet në anë tjetër t'i përgjigjet kërkesës për të bërë të kuptueshme pa vështirësi përmbajtjen e një të dhëne gjuhësore, të ndihmojë për t'i siguruar gjuhës së shkruar një fuqi kumtuese e qartësi sa më të madhe, duke pasur rëndësi për të edhe ana kuptimore e strukturore. Duke ruajtur shkrimin e njëllotë të një morfeme brenda trajtave të një fjale ose fjalëve të një vargu fjalëformues, pavarësisht nga ndryshimet fonetike pozicionale e kombinatorë që mund të pësojë ajo, ai i bën më të qarta lidhjet kuptimore e gramatikore. Duke gjetur mënyrat e shprehjes së diferencuar grafike të kuptimeve gramatikore, duke pakësuar, me sa është e mundshme, homografet që mund të sjellin moskuptime, ai i jep kthjelltësi më të madhe kumtimit. Prandaj, gjithashtu zbatimi i parimit fonetik i errëson këto lidhje kuptimore e strukturore a mund të japë raste për paqartësi, ndihet nevoja që ai t'i lëshojë vendin një parimi tjetër, parimit morfologjik. Ky parim i jep drejtshkrimit edhe një karakter më sistematizues, më koherent, më racional, me aq sa e lejon vetë gjuha e gjendja e saj.

Ja përse në drejtshkrimin e shqipes parimi fonetik plotësohet me parimin morfologjik. Sado i rëndësishëm që është ky, sfera e përdorimit të tij nuk është edhe aq e haptë në gjuhën shqipe si në ndonjë gjuhë tjetër, ai i bie ndesh parimit fonetik në një numër më të paktë rastesh. Megjithëse ka vend e arësye për t'u zbatuar ai në drejtshkrimin tonë edhe më gjerë e megjithëse del nevoja që të rishikohen në këtë drejtim një numër ortogramesh, sfera e tij mbetet se mbetet relativisht e kufizuar dhe e kushtëzuar. Ai loz një rol dytësor e jo themelor e s'mund të jetë ndryshe. Të shumtën e herës, mund të themi edhe zakonisht, ai vepron në kuadrin e mundësive fonetike të gjuhës së sotme, shpesh duke përkuar zgjidhja e tij edhe me ndonjë variant shqiptimor.

Është e vetëkuptueshme që as mund të mendohet për të rivendosur unitetin e morfemave që synon parimi morfologjik, aty ku vetë gjuha e ka thyer prej kohësh, ku kanë ndodhur shndërrime fonetike të la-

shta në pasojë fenomenesh si apofonia, metafohia, diftongimi (sh. *dredh dridhni drodha; shkrova shkruam; ftua, ftoi* etj.). Është fjala për fenomenet fonetike të gjalla e shndërrimet e sjella prej tyre. Kur kemi të bëjmë me procese plotësisht të kryera, me rezultate të një karakteri të përgjithshëm ose pak a shumë të përgjithshëm, e të konsoliduara, parimi morfologjik duhet të tërhiqet para parimit fonetik, ndryshe drejtshkrimi do të ngarkohej me trajta arkaizuese ose artificiale të papërligjura. Ortogramet *fushësë, maletë, malitë*, sado të përligjura me parimin morfologjik, pse e japin të plotë nyjën e sprasme, duke ruajtur unitetin e saj me nyjen e përparme, dhe kështu e bëjmë më të qartë strukturën, janë sot të papranueshme, pse bien në kundërshtim të hapët me gjendjen e sotme të gjuhës. Në rastet e tjera i duhet dhënë përparësia parimit morfologjik për të vendosur midis varianteve të ndryshme fonetike, ndonjëherë edhe duke mos pasqyruar me saktësi shqiptimin. Kështu është për t'u mbrojtur zbatimi i parimit morfologjik në shkrimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës a para bashkëtingëlloreve të pazëshme (*lidh, vend, elb, zog, zogj* etj.). Po ashtu ruajtja e ë-së së patheksuar të reduktuar në masa të ndryshme për qartësimin e njësisë paradigmatiske ose të lidhjeve fjalëformuese, kur këto janë të ndieshme.

6. Drejtshkrimi është kodifikim. Si i tillë, ai synon të sistematizojë, me sa është e mundur, realitetin kompleks, të lëvizshëm të një gjuhe. Ai kërkon të vërë rregulla sa më të përgjithshme, rationale. Duke qenë në një shkallë më të lartë përgjithësuese se shqiptimi, në raste të caktuara, për hir të këtij përgjithësimi, ai mund dhe duhet edhe t'i shmangët shqiptimit. Me këto shpjegohen edhe disa ortograme për kategori të kufizuara ose fjalë të caktuara, që mund të duken si jo fonetike ose jo sa duhet fonetike. Kështu për hir të vendosjes së një rregulle të vetme, është pranuar rënja e ë-së së patheksuar gjatë lakimit të gjithë emrat e mbiemrat në *-ëm*, pa përjashtuar as ata më *-shëm*, ku rënja e ë-së është më pak e përgjithësuar, më pak e konsoliduar.

Ka dalë nga diskutimi kërkesa për rregulla sa më të përgjithshme, me numër më të pakët, për mënjanim të inkonsekuencave, të përjashtimeve, të dyzimeve (dubleteve). Në drejtim të kësaj kërkesë, në thelb të drejtë, mund dhe duhet bërë më shumë, duhet shkuar më tej në rrafshime, njësimë, brenda kufijve e në masën që e lejon gjuha jonë dhe faza e saj e sotme. Gjuha është një realitet kompleks, rezultat i një zhvillimi historik të ndërlikuar. Në të ka rregullsi, por dhe anomalitë, vija të drejta dhe vija të përthyera, luftë dhe bashkëjetim elementesh të ndryshme, të vjetra dhe të reja, inkonsekuenca e përjashtime. Drejtshkrimi s'ka se si t'i mënjanojë këto krejtësisht e gjer në fund. Ai nuk mund të veprojë në mënyrë arbitrare, duke sjellë sistematitet e njësim aty ku nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme.

Por janë mundësitë që drejtshkrimi ynë t'u përgjigjet dhe më shumë detyrave përgjithësuese, sistematizuese dhe njësuere. Kjo do të arrihet me një zbatim edhe më të gjerë të parimit morfologjik, me rrafshime analogjike më të mëdha, me mosndjekjen kudo gjer në fund të parimit fonetik, me vështrimin e fakteve dhe çështjeve të ndryshme drejtshkrimore, jo në mënyrë të shkëputur, por në kuadrin e përgjithshëm të cilit i përkasin, në lidhjet sistemore të tyre. Përmirësime të

shumta mund të bëhen në këtë drejtim, pa i rënë ndesh realitetit të sotëm gjuhësor. P.sh. del i këshillueshëm të hequrit dorë nga ruajtja e ë-së së patheksuar fundore te një numër i kufizuar emrash mashkullorë si *lumë, djalë*, etj., ndofta edhe te emrat e lëndëve që tani janë bërë mashkullorë, po ashtu nga ë-ja e patheksuar fundore në vetën e dytë njëjës të urdhërores së pak foljeve me bashkëtingëllore si *folë, bjerë*, etj. që nuk është mjaftësisht e përligjur as nga ana fonetike.

\* \* \*

Si përfundim mund të themi se historia e gjuhës letrare shqipe dhe gjendja e sotme e saj, kërkesat për një drejtshkrim të lidhur ngushtë me gjuhën e gjallë të popullit, por edhe sistematizues e sa më racional që është e mundur, kanë përcaktuar karakterin gjerësisht e thellësisht fonetik të drejtshkrimit tonë, duke bërë njëkohësisht të nevojshëm zbatimin e arësyeshëm të tij me kufizimet e domosdoshme, plotësimin e tij me parimin morfologjik, në ndonjë rast edhe me ndonjë parim tjetër më dytësor. Drejtshkrim monolitik, që të ndjekë në mënyrë konsekuente gjer në fund një parim të vetëm, nuk ka pasur edhe s'ka. Përdorimi me vend i këtyre parimeve, kombinimi i drejtë i tyre, do t'i japë gjuhës sonë letrare, në fazën e sotme të kristalizimit përfundimtar të saj, kodin drejtshkrimor shkencor e praktik për të cilin ka nevojë ajo, e që do të jetë një mjet efikas i ngritjes së saj në një shkallë më të lartë përpunimi e zhvillimi për t'i shërbyer edhe më fuqishëm kulturës sonë socialiste.